

Date 27.10.2023

Procesverbal - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje Materiale Elektroda,Oksigjen për nevoja të Shoqërisë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):): Oksigjen Elektroda

Vlera e fondit limit: 5.500.000 (pese milion e peseqind mije) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht në 110.000 (njqind e dhjete mije) lekë.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021.2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit, (2020, 2021.2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjeshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$5.500.0000 \times 30\% = 1.650.000$$

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2023)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

3 Kapaciteti teknik:

3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$5.500.000 \times 20\% = 1.100.000 \text{ lekë}$$

3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbi kërkesën e autorizimit të prodhuesit është mbi

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në

përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat

ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

3.4 .Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpuethshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

II. ARGUMENTIM

MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE TË

Specifikimet teknike

Oksigjen

Oksigjen me pasterti me te madhe se 99%. Te ofrohet ne bombula me kapacitet 8-10m³ te cilat te jene te pajisura me valvula kunder zjarrit.

Acetilen

Acetilen me pasterti me te madhe se 99%. Te ofrohet ne bombula me kapacitet 4-5kg te cilat te jene te pajisura me valvul sigurie dhe nderpreres flake.

Elektroda 3.2mm

Te jene elektroda bazike per saldimin e celiqeve me permbaitje karboni neri ne 3.5%. Te jete e pershtateshme per saldime ne te gjitha pozicionet dhe me gjatesi 450mm. Te kete permbaitje karboni 0.05-0.07%, Mangani 1-1.1%, silici 0.5-0.7%, Sqfur max 0.25% dhe fosfor max 0.03%. Fortesia e elektrodave te jete me e madhe se 370mpa

Elektroda Gize 3.2mm

Te jene elektroda bazike per saldimin e te gjitha llojeve te gizes. Te jete e pershtateshme per saldim horizontal, vertikal dhe saldim ne tavan. Gjatesia te pakten 300mm dhe fortesi 200HV $\pm 10\%$. Te kete permbaitje hekuri te pakten 45%, permbaitje Nikeli te pakten 50%, Karboni te 1.2-1.6%, Silici 1.1-0.15%, Mangani 0.8-0.9% dhe alumini 0.5-1%.

Elektroda Alumini 3.2

Elektroda alumini me trashesi 3.2 mm dhe gjatesi 350mm, per saldime horizontale. Te kete permbaitje alumini 88-90%, silici 10-12% dhe hekuri 0.5-1%.

Elektroda inoksi 3.2

Te jene elektroda te pershtateshme per saldimin e depozitave te inoksit te boteve te ujit. Te krijoje nje tegel saldimi te harkuar, dhe pa deformime, per te mos dhene mundesine e mbledhjes te papastertive. Mbetjet e saldimit te jene te vete heqshme ne menyre te tille qe uji I transportuar mos te kete kontakt me keto mbetje. Tegeli I saldimit te jete rezistent ndaj klorit. Fortesia e elektrodave te jete te pakten 440MPa. Peraberja: Karbon 0.02-0.03%, Mangan 0.5-0.65%, Silic 0.5-0.65%, krom 19-20%, Nikel 10-12%, Molibden 2-3%, dhe bakerr max 0.15%. Diametri I elektrodave 3.2mm dhe gjatesia min 350mm.

Boracio

Boracio per saldim ne celik, gize, bakerr dhe bronx. Te jete ne forme pluhuri. Te jete aktiv per temperatura saldimi me oksigjen nga 800-1000°C.

Maska Saldimi elektrik

Maskat te jene me materjal qe duron temperatura minimalisht deri ne 300°C, dritarja e shikimit te maskes te jete minimalisht 100x50mm dhe pesha max 500gr.

Kominoshe per saldatorët

Kominoshe te lehta ne perdorim, me peshe maksimale 300g/m2. Materjali te jete rezistent ndaj zjarrit. Te jene sipas standartit ISO11611 ose ekuivalent. Permasat do te saktesohen ne momentin e lidhjes te kontrates.

Kanella saldimi per ngjitje

Kanella saldimi per ngjitje per perdorim me elektrode deri ne min, 1.5 mm, gjatesia e tubit jetë te pakten 4m.

Kanella per prerje

Kanella universale prerje, te pershtatshme per tu perodorur me majat e prerjes te oksigjenit 0-75

Reduktor oksigjeni

Reduktori te jete i pershtatshem per presion te pakten 300bar, me teknologji per balancimin e presionit ne dalje. Reduktori te jete i paisur me diafragme inoksi dhe valvul rezistente ndaj zjarrit. Te jete i pershtatshem per perdorim ne saldim MIG dhe TIG. Reduktoret te jene te prodhuar dhe testuar sipas standarteve SSH EN ISO 2503 dhe SSH EN ISO 5171.

Reduktor acetileni

Reduktori te jete i pershtatshem per presion te pakten 300bar, me teknologji per balancimin e presionit ne dalje. Reduktori te jete i paisur me diafragme inoksi dhe valvul rezistente ndaj zjarrit. Te jete i pershtatshem per perdorim ne saldim MIG dhe TIG. Reduktoret te jene te prodhuar dhe testuar sipas standarteve SSH EN ISO 2503 dhe SSH EN ISO 5171.

Valvol moskthimi acitilen reduktori

Valvul per moskthimin e acetilenit te reduktori, dhe izolimin e flakes.

Valvola moskthimi oksigjen te reduktorit

Valvul per moskthimin e oksigjenit te reduktori, dhe izolimin e flakes.

Valvol moskthimi acitileni te tubove

Valvula e moskthimit te acetilenit duhet te kete element te shtuar sigurie, qe ne rast zjarri te izolohehet plotesisht qe te mos lejohet rrjedhja e acetilenit.

Maja prerje (0-75) oksigjeni

Kabell Saldimi

Kabell Saldimi 16mm², I pershtatshem per tension pune minimalisht 130A.

Aparat saldimit mig-mag

Aparati i saldimit mig-mag duhet te jete automatik ose gjysem automatik. Aparati i saldimit duhet te jete i pajisur me te paktën 1 prize 16A.

Paisja te ofroje:

Saldim me tel me diametër min 0.8-1.2mm;

Funksionin e saldimit me cikël te shkurtër dhe funksionin e saldimit gjysem automatik, i cili perdoret per saldime te gjata;

Ngrohes te gazit;

Te kete 4 rollera per te siguruar vazhdueshmëri te ushqimit me tel;

Te suportoje tel ne diametër rrote 200 dhe 300mm

Lidhesi i torces te jete standart european

Rregullim i te dhënave te saldimit me ane te ekranit dixhital

Kablli te ofroje mundësinë per ndryshim polariteti

Te kete tregues per rryme me te larte se normalja

Te kete tregues tensioni

Te kete tregues per shpejtësinë e lëvizjes te telit

Te kete rregullues te këndit te saldimit.

Te kete rregullues te shpejtësisë te telit.

Te suportoje mundësin per saldimit ne celik pa përdorimin e gazit

Baraban(kabull) O 2.5-100 m

Zinxhir me 36 dhëmbë per motorsek

Vaj Mishel Motorrik

Argumentimi

Materialet e kërkuara janë standarte dhe specifikimet e tyre janë hartuar duke marrë në konsideratë funksionalitetin e produktit si dhe shërbimet profesionale te veprimtarisë së AK, sipas objektit të prokurimit. Materialet duhet të jenë funksionale dhe me permasat e duhura per realizimin e punes se perditshme te specialisteve ne terren. Specifiimet teknike jane kerkuar ne perputhje me kerkest e specialistëve të terrenit.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose Argumentim i specifikimeve teknike:

Njesia e prokurimit